

**VENDIM**  
**Nr. 223, datë 1.4.2026**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.445, DATË 31.7.2025, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “PËR ZBATIMIN E PROJEKTIT TË PORTIT TË RI TREGTAR TË INTEGRUAR TË DURRËSIT NË PORTO-ROMANO””**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Në vendimin nr.445 datë 31.7.2025, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Për zbatimin e projektit të portit të ri tregtar të integruar të Durrësit në Porto-Romano””, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Në pikat 3 dhe 4, fjalët “... vlera e përgjithshme prej 815 696 300.40 (tetëqind e pesëmbëdhjetë milionë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e treqind pikë dyzet) lekësh ...”, zëvendësohen me “... 819 943 380.4 (tetëqind e nëntëmbëdhjetë milionë e nëntëqind e dyzet e tre mijë e treqind e tetëdhjetë pikë katër) lekësh ...”;

b) Në tabelën, bashkëlidhur vendimit, bëhen ndryshimet dhe shtesa e mëposhtme:

i. Të dhënat për shpronësim në nënndarjet me numrat rendorë 54, 55, 56, 57, 58, 60, 61, 62, 63, 67, 71, 73, 76 dhe 77 zëvendësohen përkatësisht me të dhënat në nënndarjet me të njëjtin numër rendor, sipas tabelës që bashkëlidhet këtij vendimi;

ii. Pas nënndarjes me numër rendor 290 shtohet nënndarja me numër rendor 291, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi;

iii. Në paragrafin “Shënim”, në fund të tabelës, fjalët “... negociohet brenda 6 (gjashtë) muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.” zëvendësohen me “... negociohet brenda 6 (gjashtë) muajve nga hyrja në fuqi e aktit nënligjor për detajimin e metodologjisë së shkëmbimit në natyrë në zbatim të procedurës për shpronësim për realizimin e projektit të portit të ri tregtar të integruar të Durrësit në Porto-Romano.”.

2. Shpenzimet procedurale, në vlerën 90 000 (nëntëdhjetë mijë) lekë, përballohen nga Autoriteti Portual Durrës.

3. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoriteti Portual Durrës, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Durrës-Kavajë-Krujë, Drejtoria e Administrimit dhe e Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Durrës dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR**  
**Edi Rama**

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK NGA KËRKESA “PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME, NË VENDIMIN NR . 445, DATË 31.7.2025, “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONE PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT ‘PËR ZBATIMIN E PROJEKTIT TË PORTIT TË RI TREGTAR TË INTEGRUAR TË DURRËSIT NË PORTO – ROMANO”

|     | P R O N A R I                                                                                         |                                                                   |                                                                              | TË DHËNAT KADASTRALE (SIPAS KARTELËS SË PASURISË) |      |                   |                     |                                           |                            |                               |                                 |        |      | VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM                        |                                 |                 |                                                  |                                 |                 |                                                  |                               |                                                  |                                 |                 |                           | SHËNIMI<br>(Kufizime<br>hipotekore,<br>barrë mbi<br>pasurinë<br>etj.) |  |
|-----|-------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------|------|-------------------|---------------------|-------------------------------------------|----------------------------|-------------------------------|---------------------------------|--------|------|--------------------------------------------------|---------------------------------|-----------------|--------------------------------------------------|---------------------------------|-----------------|--------------------------------------------------|-------------------------------|--------------------------------------------------|---------------------------------|-----------------|---------------------------|-----------------------------------------------------------------------|--|
|     |                                                                                                       |                                                                   |                                                                              |                                                   |      |                   |                     |                                           |                            |                               |                                 |        |      | "ARË"                                            |                                 |                 | "TRUALL"                                         |                                 |                 | NDËRTESE SOCIAL-<br>EKONOMIKE                    |                               | "PYLL"                                           |                                 |                 | VLERA<br>TOTALE<br>(lekë) |                                                                       |  |
| NR. | Emri                                                                                                  | Atësia                                                            | Mbiemri                                                                      | Fshati ose<br>Qyteti                              | ZK   | Nr. i<br>pasurisë | Lloji i<br>pasurisë | Sipërfaqja<br>Totale<br>(m <sup>2</sup> ) | "Arë"<br>(m <sup>2</sup> ) | "Truall"<br>(m <sup>2</sup> ) | "Ndërtesë"<br>(m <sup>2</sup> ) | Volumi | Faqe | Sipërfaqja e<br>shpronësuar<br>(m <sup>2</sup> ) | Cmimi<br>(lekë/m <sup>2</sup> ) | Vlera<br>(lekë) | Sipërfaqja e<br>shpronësuar<br>(m <sup>2</sup> ) | Cmimi<br>(lekë/m <sup>2</sup> ) | Vlera<br>(lekë) | Sipërfaqja e<br>shpronësuar<br>(m <sup>2</sup> ) | Vlera<br>sipas<br>preventivit | Sipërfaqja e<br>shpronësuar<br>(m <sup>2</sup> ) | Cmimi<br>(lekë/m <sup>2</sup> ) | Vlera<br>(lekë) |                           |                                                                       |  |
|     | A                                                                                                     | B                                                                 | C                                                                            | C                                                 | Ç    | D                 | E                   | F                                         | G                          | H                             | I                               | J      | K    | L                                                | M                               | N               | O                                                | P                               | Q               | R                                                | T                             | L                                                | M                               | N               | Y                         | Z                                                                     |  |
| 54  | GLOBAL TRADING COMPANY                                                                                |                                                                   |                                                                              | SPITALLE                                          | 8517 | 18/2              | ARË                 | 5,200                                     |                            |                               |                                 | 14     | 150  | 5,200                                            | 356                             | 1,851,200       |                                                  |                                 |                 |                                                  |                               |                                                  |                                 |                 | 1,851,200.00              |                                                                       |  |
| 55  | MUHARREM                                                                                              | RIZA                                                              | BARDHOCI                                                                     | SPITALLE                                          | 8517 | 18/3              | ARË                 | 5,200                                     |                            |                               |                                 | 14     | 145  | 5,200                                            | 356                             | 1,851,200       |                                                  |                                 |                 |                                                  |                               |                                                  |                                 |                 | 1,851,200.00              |                                                                       |  |
| 56  | GLOBAL TRADING COMPANY                                                                                |                                                                   |                                                                              | SPITALLE                                          | 8517 | 18/4              | ARË                 | 5,200                                     |                            |                               |                                 | 14     | 152  | 5,200                                            | 356                             | 1,851,200       |                                                  |                                 |                 |                                                  |                               |                                                  |                                 |                 | 1,851,200.00              |                                                                       |  |
| 57  | GLOBAL TRADING COMPANY                                                                                |                                                                   |                                                                              | SPITALLE                                          | 8517 | 18/5              | ARË                 | 5,500                                     |                            |                               |                                 | 14     | 153  | 5,500                                            | 356                             | 1,958,000       |                                                  |                                 |                 |                                                  |                               |                                                  |                                 |                 | 1,958,000.00              |                                                                       |  |
| 58  | GLOBAL TRADING COMPANY                                                                                |                                                                   |                                                                              | SPITALLE                                          | 8517 | 18/6              | ARË                 | 5,500                                     |                            |                               |                                 | 14     | 154  | 5,500                                            | 356                             | 1,958,000       |                                                  |                                 |                 |                                                  |                               |                                                  |                                 |                 | 1,958,000.00              |                                                                       |  |
| 60  | GLOBAL TRADING COMPANY                                                                                |                                                                   |                                                                              | SPITALLE                                          | 8517 | 18/8              | ARË                 | 5,500                                     |                            |                               |                                 | 14     | 156  | 5,500                                            | 356                             | 1,958,000       |                                                  |                                 |                 |                                                  |                               |                                                  |                                 |                 | 1,958,000.00              |                                                                       |  |
| 61  | GLOBAL TRADING COMPANY                                                                                |                                                                   |                                                                              | SPITALLE                                          | 8517 | 18/9              | ARË                 | 6,050                                     |                            |                               |                                 | 14     | 157  | 6,050                                            | 356                             | 2,153,800       |                                                  |                                 |                 |                                                  |                               |                                                  |                                 |                 | 2,153,800.00              |                                                                       |  |
| 62  | GLOBAL TRADING COMPANY                                                                                |                                                                   |                                                                              | SPITALLE                                          | 8517 | 18/10             | ARË                 | 8,700                                     |                            |                               |                                 | 14     | 158  | 8,700                                            | 356                             | 3,097,200       |                                                  |                                 |                 |                                                  |                               |                                                  |                                 |                 | 3,097,200.00              |                                                                       |  |
| 63  | GLOBAL TRADING COMPANY                                                                                |                                                                   |                                                                              | SPITALLE                                          | 8517 | 18/11             | ARË                 | 8,350                                     |                            |                               |                                 | 14     | 159  | 8,350                                            | 356                             | 2,972,600       |                                                  |                                 |                 |                                                  |                               |                                                  |                                 |                 | 2,972,600.00              |                                                                       |  |
| 67  | NAXHIJE<br>ZEMRITE<br>ZYRA<br>FADIL<br>REMIJE<br>ERIGLENT<br>LEONTINA<br>LORISA<br>FATBARDHA<br>ELIOS | BAJRAM<br>VOKË<br>VOK<br>VOKË<br>OSMAN<br>OSMAN<br>MUSLI<br>OSMAN | VOKA<br>HALILAJ<br>CAHANI<br>VOKA<br>PALUSHI<br>VOKA<br>VOKA<br>VOKA<br>VOKA | SPITALLE                                          | 8517 | 19/4              | ARË                 | 5,070                                     |                            |                               |                                 | 14     | 220  | 5,070                                            | 356                             | 1,804,920       |                                                  |                                 |                 |                                                  |                               |                                                  |                                 |                 | 1,804,920.00              |                                                                       |  |
| 71  | FETAH                                                                                                 | ISUF                                                              | ELEZI                                                                        | SPITALLE                                          | 8517 | 19/8              | ARË                 | 9,672                                     |                            |                               |                                 | 15     | 181  | 9,672                                            | 356                             | 3,443,232       |                                                  |                                 |                 |                                                  |                               |                                                  |                                 |                 | 3,443,232.00              |                                                                       |  |
| 73  | YLBER                                                                                                 | ISUF                                                              | ELEZI                                                                        | SPITALLE                                          | 8517 | 20/2              | ARË                 | 3,696                                     |                            |                               |                                 | 13     | 244  | 3,696                                            | 356                             | 1,315,776       |                                                  |                                 |                 |                                                  |                               |                                                  |                                 |                 | 1,315,776.00              |                                                                       |  |
| 76  | DRITA<br>ARMAND<br>SIBORA<br>KLEVIS<br>LIRIE                                                          | SHEFKI<br>ZYLFI<br>ZYLFI<br>ZYLFI<br>ZYLFI                        | MUÇMATA<br>MUÇMATA<br>MUÇMATA<br>MUÇMATA<br>MUÇMATA                          | SPITALLE                                          | 8517 | 20/6              | ARË                 | 6,500                                     |                            |                               |                                 | 22     | 191  | 6,500                                            | 356                             | 2,314,000       |                                                  |                                 |                 |                                                  |                               |                                                  |                                 |                 | 2,314,000.00              |                                                                       |  |
| 77  | ALGERT                                                                                                | SUL                                                               | VOKA                                                                         | SPITALLE                                          | 8517 | 20/9              | ARË                 | 17,220                                    |                            |                               |                                 | 15     | 145  | 17,220                                           | 356                             | 6,130,320       |                                                  |                                 |                 |                                                  |                               |                                                  |                                 |                 | 6,130,320.00              |                                                                       |  |
| 291 | FATMIR                                                                                                | ZAIM                                                              | MEHMETI                                                                      | SPITALLE                                          | 8517 | 20/8              | ARË                 | 1500                                      |                            |                               |                                 | 18     | 138  | 1500                                             | 356                             | 534,000         |                                                  |                                 |                 |                                                  |                               |                                                  |                                 |                 | 534,000.00                |                                                                       |  |
|     | SHUMA TOTALE                                                                                          |                                                                   |                                                                              |                                                   |      |                   |                     |                                           |                            |                               |                                 |        |      |                                                  |                                 |                 |                                                  |                                 |                 |                                                  |                               |                                                  |                                 | 35,193,448.00   |                           |                                                                       |  |
|     | EFEKTI FINANCIAR SHITESË                                                                              |                                                                   |                                                                              |                                                   |      |                   |                     |                                           |                            |                               |                                 |        |      |                                                  |                                 |                 |                                                  |                                 |                 |                                                  |                               |                                                  |                                 | 4,247,080.00    |                           |                                                                       |  |